

Përmbledhje e Urdhrit për Zhdëmtim

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës (KSC-BC-2020-05)

Trupi Gjykses I do të shqiptojë sot Urdhrin për Zhdëmtim në çështjen gjyqësore *Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës*. Ky Urdhër për Zhdëmtim shqiptohet publikisht dhe në praninë e z. Mustafa.

1. Ndonëse do të lexoj përmbledhjen e konstatimeve kryesore të Trupit Gjykses, kjo përmbledhje nuk është pjesë e Urdhrit për Zhdëmtim, i cili është i vetmi version autoritativ i vendimit dhe konstatimeve të Trupit Gjykses. Përmbledhja që nuk është version autoritativ, do të jetë e disponueshme në faqen e internetit të DHSK-së.

2. Fillimisht, dua të theksoj se seanca e sotme shënon edhe një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara të Kosovës, meqenëse lëshohet urdhri i parë për zhdëmtim i kësaj Gjykate. Zhdëmtimi është pjesë themelore e proceseve gjyqësore në DHSK. Ai është thelbësor për realizimin e drejtësisë për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare.

3. Ky Urdhër për Zhdëmtim buron nga shpallja e fajësisë kundër z. Salih Mustafa, e datës 16 dhjetor 2022. Në këtë kontekst, rikujtoj se ky Grup Gjykses shpalli z. Mustafa fajtor lidhur me 3 akuza për krime të luftës, përkatësisht për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme, të cilat ai i kreu, drejtpërdrejt dhe si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999, në një kompleks në Zllash, në Kosovë. Z. Mustafa u dënua me 26 vjet burgim, brenda të cilit i llogaritet koha e kaluar në objektin e paraburgimit të DHSK-së nga 24 shtatori 2020.

4. Rikujtoj se viktimat pjesëmarrëse në proces ishin nën masa mbrojtëse, përkatësisht që emrat dhe të dhënat e tyre identifikuese të mos u bëhen të njohura publikut. Në përputhje me këtë, gjatë kësaj seance, viktimave do t'u referohem me

kodet që u janë caktuar. Trupi Gjykses gjithashtu ka shqyrtuar me kujdes se çfarë informacioni tjetër mund të nxirret publikisht, duke ruajtur ekuilibrin midis nevojës për të mbrojtur viktimat dhe parimit të procesit publik.

Tani do të filloj përmbledhjen e Urdhrit për Zhdëmtim.

Historiku Procedural

5. Do të jap një përmbledhje të shkurtër të procesit.
6. Më 4 shkurt 2022, Trupi Gjykses I gjykoi se në rast të një vendimi fajësie, nuk do t'i udhëzonte viktimat të ngrinin padi civile në gjykata të Kosovës, por do të nxirrte një urdhër për zhdëmtim. Procesi në lidhje me zhdëmtimin, për rrjedhojë, u zhvillua paralelisht me gjykimin.
7. Më 30 qershor 2022, mbrojtësja e viktimave dorëzoi një kërkesë për zhdëmtim në emër të tetë viktimave të pranuar si viktima pjesëmarrëse në proces.

Dispozitat ligjore dhe parimet e zbatueshme

Pasqyra e plotë e dispozitave ligjore dhe parimeve të zbatueshme jepet në versionin publik të urdhrit për zhdëmtim. Në kuadër të kësaj përmbledhjeje, do të nënvizoj si vijon.

8. Trupi Gjykses thekson se zhdëmtimi në Dhomat e Specializuara të Kosovës ka për qëllim jo vetëm ndëshkimin e personit të shpallur fajtor, sikurse parashikohet në nenin 44(6) të Ligjit, por edhe njohjen dhe zhdëmtimin, për aq sa është e mundur, të dëmit që u është shkaktuar viktimave.
9. Në përputhje me këtë, viktimat duhet të marrin dëmshpërblim të arsyeshëm, të përshtatshëm dhe të shpejtë.
10. **Sa u përket parimeve të zbatueshme për përgjegjësinë e personit të shpallur fajtor në lidhje me zhdëmtimin,** Trupi Gjykses gjykoi se urdhri për zhdëmtim nuk

mund të dalë jashtë kuadrit të veprave penale për të cilat personi është shpallur fajtor, dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat kundër personit të shpallur fajtor.

11. Përgjegjësia e personave apo organizatave të tjera, ose përgjegjësia e shtetit, nuk është relevante në përcaktimin e përgjegjësisë së personit të shpallur fajtor lidhur me zhdëmtimin.

12. Po kështu, mungesa e mjeteve financiare të personit të shpallur fajtor nuk është relevante në marrjen e këtij vendimi.

Vlerësimi i provave

13. Shkurtimisht do të trajtoj metodologjinë që përdori Trupi Gjykses në vlerësimin e provave që paraqitën viktimat lidhur me zhdëmtimin.

14. Para së gjithash, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet faktike dhe ligjore të bëra në Aktgjykimin e Trupit Gjykses, të cilat çuan në shpalljen e fajësisë dhe dënimin e z. Mustafa.

15. Trupi Gjykses gjithashtu shqyrtoi, ndër të tjera: Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim, Deklaratën për Pasojat; Aktekspertizat e iMMO-së (“Instituti për Të Drejtat e Njeriut dhe Vlerësim Mjekësor”) dhe Raportin *Lerz*.

16. Së fundi, Trupi Gjykses vuri re se gjatë gjithë procesit gjyqësor, Mbrojtja mbajti të njëjtin qëndrim, përkatësisht se për shkak të mohimit prej z. Mustafa të çfarëdo përgjegjësie për krimet e paraqitura në aktakuzë, ai nuk është i detyruar t’i dëmshpërblejë viktimat. Rrjedhimisht, Mbrojtja nuk paraqiti parashtrime materiale në kontekstin e procesit të zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore.

Shkalla dhe përmasat e dëmit

17. Përpara se të kaloj tek Urdhri për Zhdëmtim kundër z. Mustafa, do të bëj një përmbledhje të konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me **shkallën dhe përmasat e**

dëmit që pësuan viktimat pjesëmarrëse në këtë proces, në përputhje me nenin 22(7) të Ligjit.

18. Do të filloj me parashtrimet e Mbrojtëses së Viktimave.

19. Mbrojtësja e Viktimave dorëzoi një kërkesë për zhdëmtim në emër të tetë (8) viktimave pjesëmarrëse.

20. Mbrojtësja e Viktimave argumentoi se viktima 08, viktima 09 dhe viktima 10 (më tej në tekst: viktimat e drejtpërdrejta), pësuan dëm fizik, mendor dhe material si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës, të kryera kundër tyre nga z. Mustafa.

21. Ajo gjithashtu argumentoi se viktima 05, viktima 06, viktima 11, viktima 12 dhe viktima 13 (më tej në tekst: viktimat jo të drejtpërdrejta) pësuan dëm mendor afatgjatë si pasojë e krimeve të luftës të arrestimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, të kryera nga z. Mustafa kundër anëtarit të familjes së tyre, me të cilin kishin pasur një lidhje të ngushtë.

Tani do të kaloj te konstatimet e Trupit Gjykses.

22. Do të jap një përmbledhje të shkurtër të konstatimeve të Trupit Gjykses për secilën prej viktimave.

23. Do të filloj me viktimat e drejtpërdrejta.

24. Së pari, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet e bëra në Aktgjykimin e Trupit Gjykses se viktimat 08, 09 dhe 10 u ndaluan arbitrarisht dhe torturuan në kompleksin e ndalimit në Zllash nga z. Mustafa dhe vartësit e tij në BIA, dhe pësuan dëm fizik dhe mendor si pasojë.

25. Sa i përket dëmit fizik që pësoi viktima 09, Trupi Gjykses gjykoi se viktima u keqtrajtua pothuajse për çdo ditë gjatë kohës që u mbajt i ndaluar. Ai u mbajt në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese. Për pasojë, atij iu shkaktuan lëndime të shumta. Edhe sot e kësaj dite, ai vuan fizikisht.

26. Sa i përket dëmit mendor, Trupi Gjykues gjykoi se gjatë kohës që u mbajt i ndaluar në Zllash, viktima 09 mundi t'i dëgjonte të ndaluarit e tjerë kur keqtrajtoheshin dhe pa lëndimet që iu ishin shkaktuar kur i kthyen në ahur: ishin të mavijosur, të përgjakur dhe pa vetëdije. Ai jetonte me frikën e vazhdueshme se mund t'i vinte radha për t'u keqtrajtuar. Kjo i shkaktoi ngarkesë të jashtëzakonshme psikologjike.

27. Viktima 09 gjithashtu ka simptoma të çrregullimit të stresit pastraumatik.

28. Krahas kësaj, në lidhje me dëmin mendor, Trupi Gjykues vërejti se menjëherë pas krimeve, viktima 09 nuk ishte në gjendje të bisedonte për ndalimin e tij me asnjërin nga viktimat e tjera, meqenëse ata refuzuan të bisedonin me të për shkak se, sipas tij, kishin frikë. Ai nuk ishte në gjendje t'i tregonte as mjekut shkakun e vërtetë të lëndimeve që kishte.

29. Trupi Gjykues konstatoi se kjo ishte pasojë e stigmatizimit shoqëror që kishte filluar në Zllash, kur z. Mustafa si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, së si dhe anëtarë të tjerë të BIA-s, i etiketuan të ndaluarit në kompleksin në Zllash si "bashkëpunëtorë" dhe "tradhtarë", ndër të tjerë edhe viktimën 09, çka e veçoi atë nga komuniteti i tij. Duke vepruar kështu, z. Mustafa kontribuoi në krijimin e ndjenjës së izolimit dhe stigmatizimin shoqëror të viktimës 09. Nga ana tjetër, viktimës 09 nuk iu dha mundësia për të përpunuar traumën.

30. Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se në lidhje me dëmin material, Viktima 09 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të planeve për jetën, meqenëse iu privua mundësia për të pasur një karrierë normale.

31. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se viktima 09 përjetoi dëm fizik dhe material me pasojë afatgjatë, si dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

32. **Tani do të kaloj te viktima 08.**

33. Sa i përket dëmit fizik, keqtrajtimi që iu shkaktua viktimës 08 e la atë me dhimbje dhe të mavijosur.

34. Sa i përket dëmit mendor, viktima 08 ishte dëshmitar i keqtrajtimit brutal të të ndaluarve të tjerë, dhe vazhdon të ketë frikë edhe sot e kësaj dite. Viktima 08 shfaq simptoma të çrregullimit të stresit pastraumatik. Viktima 08 gjithashtu ka përjetuar pasoja negative në marrëdhëniet personale dhe jetën familjare. Për këtë arsye, ai gjithashtu ka pësuar dëmtim të planeve për jetën, në kuadër të dëmit mendor. Krahas kësaj, me etiketimin e viktimës 08 si “bashkëpunëtor”, z. Mustafa, si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, së bashku me anëtarë të tjerë të BIA-s, e veçoi atë nga komuniteti i tij dhe në këtë mënyrë, z. Mustafa kontribuoi në krijimin e ndjenjës së frikës të viktimës 08 për të folur për çfarë i kishte ndodhur në Zllash apo për të kërkuar fajtorët për ato ngjarje. Viktimës 08 gjithashtu nuk iu dha asnjëherë hapësirë për të përpunuar traumën që iu shkaktua nga koha e kaluar në Zllash.

35. Sa i përket dëmit material, trauma e fortë mendore që përjetoi viktima 08 ndikoi në mundësinë e tij për të zhvilluar karrierën. Për këtë arsye, Trupi Gjykses konstaton se viktima 08 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të planeve për jetën.

36. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se viktima 08 përjetoi: dëm fizik pa pasoja afatgjata, dëm mendor me pasoja afatgjata, dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

37. **Tani do të kaloj te viktima 10.**

38. Sa i përket dëmit fizik, viktima 10 u keqtrajtua pothuajse për çdo ditë dhe u mbajt në kushte poshtëruese dhe çnjerëzore. Për pasojë, atij iu shkaktuan lëndime nga të cilat ende nuk është rimëkëmbur.

39. Sa i përket dëmit mendor, viktima 10 u tmerrua nga zërat e të tjerëve që bërtisnin dhe rriheshin, si dhe nga frika e vazhdueshme se edhe atij mund t'i vinte radha për t'u keqtrajtuar. Viktima 10 vazhdon të vuajë edhe sot e kësaj dite.

40. Trupi Gjykues në kuadër të dëmit mendor gjithashtu vlerësoi se, përmes etiketimit të viktimës 10 si “bashkëpunëtor” gjatë kohës së mbajtjes së tij në ndalim në Zllash, z. Mustafa, si pjesë e një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët, së bashku me anëtarë të tjerë të BIA-s, veçoi viktimën 10 nga komuniteti i tij. Në këtë mënyrë, z. Mustafa kontribuoi në pamundësinë e viktimës 10 për të kërkuar haptas ndihmë për shërimin e traumës që iu shkaktua nga koha e mbajtjes së tij në ndalim në Zllash.

41. Në lidhje me dëmin material, Trupi Gjykues gjykoi se, si rezultat i torturës së përjetuar në Zllash, Viktima 10 pësoi humbje të ardhurash dhe dëmtim të planeve për jetën.

42. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se viktimia V10 përjetoi dëm fizik dhe mendor me pasoja afatgjata, si dhe dëm material, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor.

43. Tani do të jap një përmbledhje të shkallës dhe përmasave të dëmit që pësuan viktimat jo të drejtpërdrejta.

44. Së pari, Trupi Gjykues u mbështet në konstatimet e bëra në Aktgjykimin e Trupit Gjykues në lidhje me ndalimin arbitrar, torturën dhe vrasjen e paligjshme të një të ndaluarit në kompleksin e ndalimit në Zllash, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor. Këtij të ndaluarit do t’i referohem me “viktimia e vrasjes së paligjshme”.

45. Trupi Gjykues vlerësoi se arrestimi e ndalimi arbitrar dhe më pas vrasja e paligjshme e viktimës së vrasjes së paligjshme, si dhe rrethanat e tyre, patën pasoja shkatërrimtare mbi viktimat jo të drejtpërdrejta. Ata përjetuan pikëllim, dhimbje shpirtërore dhe tmerr. Për më tepër, ata nuk kanë qenë në gjendje të kalojnë pikëllimin për humbjen e të afërmit të tyre. Kjo ua ka bërë më të vështirë për të vazhduar me jetën e tyre.

46. Trupi Gjykues gjithashtu gjykoi se dhimbja dhe vuajtjet që përjetuan anëtarët e familjes së viktimës së vrasjes së paligjshme kanë ndikuar edhe në gjeneratën më të re të kësaj familjeje.

47. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se viktimat jo të drejtpërdrejta përjetuan dëm mendor si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme, për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor në lidhje me viktimën e vrasjes së paligjshme.

48. Këtu përfundojnë konstatimet e Trupit Gjykses në lidhje me shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat, dhe tani do të kaloj tek Urdhri për Zhdëmtim kundër z. Mustafa.

Urdhri për Zhdëmtim kundër z. Mustafa

49. Ky urdhër jepet drejtpërdrejt kundër z. Mustafa.

Përfituesit e zhdëmtimit

50. Përfitues të zhdëmtimit janë tri viktimat e drejtpërdrejta dhe pesë viktimat jo të drejtpërdrejta të përmendura më herët.

Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimit

51. Në lidhje me llojet dhe modalitetet e zhdëmtimit, Trupi Gjykses vendosi si vijon.

52. Në marrjen e vendimit, Trupi Gjykses mbajti parasysh faktin që shpallja e fajësisë dhe dënimi i shqiptuar në Aktgjykimin e Trupit Gjykses përbëjnë një lloj mjeti juridik -në formën e njohjes – për viktimat.

53. Kjo gjithashtu u dha viktimave mundësinë për të kërkuar dhe marrë drejtësi për krimet kundër tyre ose një anëtar të familjes së tyre, që u kryen më shumë se dy dekada më parë. Së fundi, kjo kontribuoi në të drejtën e viktimave, të familjeve të tyre dhe të komunitetit të tyre, për të pasur qasje në të vërtetën.

54. Për arsyet e shtjelluara në Urdhrin për Zhdëmtim, Trupi Gjykes gjykoj se kompensimi i secilës viktimë është lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm i zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore.

55. Megjithëse, sikurse u shpreh edhe mbrojtësja e viktimave, asnjë shumë parash nuk do mund të kthejë anëtarin e humbur të familjes dhe as të ndreqë vitet e depresionit, e një jete të privuar nga mundësia për të punuar si më parë dhe për të jetuar një jetë që ka vend për gëzim e lumturi, kompensimi do të mundësojë njëfarë lehtësime financiar për viktimat.

Kuadri i përgjegjesisë së z. Mustafa për zhdëmtimet

56. Tani do të trajtoj kuadrin e përgjegjesisë së z. Mustafa për zhdëmtimet. Do të filloj me kërkesat e mbrojtëses së viktimave.

57. Mbrojtësja e viktimave në lidhje me viktimën 08 kërkoi më së paku 30.000 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

58. Në lidhje me viktimën 09, mbrojtësja e viktimave kërkoi më së paku 80.000 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

59. Në lidhje me viktimën 10, mbrojtësja e viktimave kërkoi më së paku 60.000 euro për dëm material, fizik dhe mendor.

60. Së fundi, mbrojtësja e viktimave kërkoi nga 10.000 euro për viktimën 05, viktimën 06 dhe viktimën 12; 5.000 euro për viktimën 11 dhe 2.000 euro për viktimën 13, si kompensim për dëmin mendor.

61. Tani do të kaloj në vendimin e Trupit Gjykes lidhur me kuadrin e përgjegjesisë së z. Mustafa për zhdëmtimet.

62. Së pari, z. Mustafa ka përgjegjësinë për kompensimin e dëmit që iu shkaktua të gjitha viktimave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të krimeve për të cilat u shpall fajtor. Kjo është pavarësisht nga format e ndryshme të përgjegjesisë penale mbi

të cilat u mbështet shpallja e fajësisë, dhe pavarësisht nëse edhe të tjerë mund të kenë kontribuar në shkaktimin e dëmit.

63. Së dyti, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë nga një shumë për secilin lloj të dëmit – dhe gjithashtu një shumë të gjithsejtë për përgjegjësinë financiare të z. Mustafa – që e gjykon të arsyeshme, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

64. Për më tepër, kur përcaktoi shumën për përgjegjësinë financiare të z. Mustafa, Trupi Gjykses mori parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat, si dhe Kërkesën e Mbrojtëses së Viktimave për Zhdëmtim.

65. Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh legjislacionin përkatës të Kosovës. Ky legjislacion trajton të drejtat dhe përfitimet që kategori të ndryshme personash të prekur nga konflikti i armatosur në Kosovë midis viteve 1998 dhe 1999, gëzojnë. Në këto kategori përfshihen: veteranët dhe civilët që pësuan dëm gjatë konfliktit të armatosur; ata që morën pjesë në luftë; dhe familjarët e anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të civilëve të vdekur ose të zhdukur. Trupi Gjykses vendosi të mbështetej në këtë legjislacion si pikë reference për përcaktimin e dëmshpërblimit që e gjykon të arsyeshëm në kontekstin e Kosovës.

66. Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh Raportin *Lerz*. Trupi Gjykses vuri re se raporti në fjalë përmbante vlerësime të përafërta të humbjeve ekonomike të viktimave të drejtpërdrejta.

67. Po ashtu, Trupi Gjykses vlerësoi se këto shuma nuk ishin shproporcionale në krahasim me kompensimet ekzistuese sipas legjislacionit të Kosovës, sikurse u përmend më herët.

68. Sa u përket viktimave jo të drejtpërdrejta, Trupi Gjykses vlerësoi se shumatat që kërkoi mbrojtësja e viktimave si kompensim për dëmin që pësuan viktimat, ishin në përputhje me ato në lidhje me viktimat e drejtpërdrejta – megjithëse pasqyrojnë lloj të ndryshëm të dëmit mendor.

69. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se shumatat që kërkoi mbrojtësja e viktimave pasqyronin shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat dhe ishin të arsyeshme, sikurse parashikohet në nenin 22(3) të Ligjit.

70. Mbi bazën e konstatimeve të mësipërme, duke mbajtur parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan viktimat e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta dhe në raste paqartësish, duke vendosur në favor të personit të shpallur fajtor, Trupi Gjykses caktoi shumën e gjithsejtë të dëmshpërblimit për të cilin z. Mustafa mban përgjegjësi ligjore në 207.000 euro (dyqind e shtatë mijë euro) .

71. Rrjedhimisht, z. Mustafa urdhërohet t'u paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:

- 30.000 euro viktimës 08;
- 80.000 euro viktimës 09;
- 60.000 euro viktimës 10;
- nga 10.000 euro viktimës 05, viktimës 06, dhe viktimës 12;
- 5.000 euro viktimës 11; dhe
- 2.000 euro viktimës 13.

72. Këtu përfundon vendimi i Trupit Gjykses në lidhje me përgjegjësinë financiare të z. Mustafa për zhdëmtimin.

73. Pjesa e fundit e Urdhrit për Zhdëmtim ka të bëjë me vënien në jetë dhe zbatimin e tij

Vënia në jetë dhe zbatimi

Monitorimi dhe mbikëqyrja

74. Trupi Gjykses theksoi se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore do të përfundojë me nxjerrjen e këtij Urdhri për Zhdëmtim.

75. Për këtë arsye, Trupi Gjykses ftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara të Kosovës të caktojë një autoritet gjyqësor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimin të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

Financimi i Urdhrit për Zhdëmtim

Nga personi i shpallur fajtor

76. Sa i përket zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykses nënvizoi se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit për viktimat, të caktuar nga ky Grup Gjykses, e mban ekskluzivisht z. Mustafa.

77. Trupi Gjykses megjithatë theksoi se në kohën e lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, z. Mustafa nuk zotëron mjete financiare për zbatimin e plotë të këtij urdhri. Trupi Gjykses rrjedhimisht konstatoi se zotit Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare për zhdëmtim. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vendosi që si shtojcë të këtij Urdhri për Zhdëmtim, të lëshojë një vendim për urdhërimin e dorëzimit të të dhënave dhe dokumenteve në lidhje me z. Mustafa, për të parë nëse pasuria aktuale e tij mund të përdoret për zbatimin, megjithëse të pjesshëm, të këtij Urdhri për Zhdëmtim. Sidoqoftë, fakti se zotit Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare nuk e liron atë nga detyrimi ndaj viktimave, dhe ai mbetet përgjegjës për shumën e plotë të dëmshpërblimit të caktuar. Në lidhje me këtë, autoriteti gjyqësor që do të caktohet nga Kryetarja e DHSK-së, do të jetë përgjegjës për monitorimin në vazhdimësi të gjendjes financiare të z. Mustafa, me qëllim zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim

78.

79. Duke marrë parasysh gjendjen financiare të z. Mustafa, Trupi Gjykses theksoi nevojën për përfshirjen e aktorëve të tjerë për zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim.

Nga Kosova

80. Trupi Gjykses theksoi se një nga aktorët e parë të tillë mund të jetë Kosova.

Programi për kompensimin e viktimave të krimit

81. Në parashtrimet e saj, Ministria e Drejtësisë e Kosovës e informoi Trupin Gjykses se viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së mund t'u akordohet kompensim ose dëmshpërblim nga programi për kompensimin e viktimave të krimit, i cili u themelua në bazë të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Ky program kompensimi mund të aktivizohet kur është përcaktuar se personi i shpallur fajtor nuk është në gjendje të paguajë kompensimin, qoftë plotësisht ose pjesërisht. Edhe pse ky ligj kohët e fundit u shfuqizua dhe u zëvendësua me një ligj të ri, parashtrimet e Ministrisë së Drejtësisë mbeten relevante edhe në kontekstin e ligjit të ri.

82. Për të ruajtur anonimitetin e viktimave pjesëmarrëse në proceset e DHSK-së dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre, Trupi Gjykses gjykoi se Administratorja, në koordinim me Mbrojtësen e Viktimave, janë personat më të përshtatshëm për të kërkuar kompensim prej Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në emër të viktimave.

83. Sidoqoftë, Trupi Gjykses vuri në dukje nevojën për parashikimin e mënyrave të tjera për zbatimin e plotë të Urdhrit për Zhdëmtim, duke mbajtur parasysh shumatat maksimale që mund të akordohen nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Tani do të flas për një mënyrë tjetër zbatimi, konkretisht krijimin e një mekanizmi të ri për zhdëmtim në Kosovë

84. Trupi Gjykses vuri re faktin që Kosova nuk ndërmoi asnjë hap nga ana e saj për t'u përgatitur konkretisht për nevojën për të mundësuar zhdëmtimin e viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Trupi Gjykses gjithashtu theksoi se Kosova parashikoi nevojën për të mbështetur financiarisht mbrojtjen e të dyshuarve dhe të akuzuarve para DHSK-së.

85. Gjithashtu, Trupi Gjykses vërejti se legjislacioni i Kosovës që trajton dëmin dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, u referohet ekskluzivisht viktimave të forcave të armikut dhe jo të gjitha viktimave të luftës në

Kosovë. Për mendimin e Trupit Gjykses, këto ligje krijuan diskriminim midis viktimave të kësaj lufte.

86. Trupi Gjykses bëri të ditur se nuk ka kompetenca për të urdhëruar Kosovën të paguajë dëmshpërblimin që u është akorduar viktimave.

87. Megjithatë, Trupi Gjykses e vlerësoi të rëndësishme t'i kujtonte Kosovës detyrimet e saj në lidhje me të drejtën e viktimave për mjet juridik efektiv, të mishëruar në nenin 54 të Kushtetutës dhe në marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo e drejtë përfshin gjithashtu edhe detyrën për të garantuar zbatimin e një mjeti të tillë juridik.

88. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses i bëri thirrje Kosovës të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm për zhdëmtim, me qëllim kompensimin e plotë të viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Sipas Trupit Gjykses, kjo do të garantonte, brenda sistemit ligjor të Kosovës, një trajtim të barabartë midis viktimave dhe të dyshuarve ose të akuzuarve në proceset e DHSK-së.

89. Trupi Gjykses gjithashtu nënvizoi se në krijimin e një mekanizmi të tillë për zhdëmtim, duhet shqyrtuar mundësia e financimit të tij përmes buxhetit të Kosovës meqenëse edhe mbrojtja e të dyshuarve dhe të akuzuarve para DHSK-së financohet përmes atij buxheti. Trupi Gjykses vlerëson se një përdorim i tillë i barabartë i buxhetit të Kosovës do të promovonte mandatin e DHSK-së sipas nenit 1(2) të Ligjit, të mbështetur nga Kosova dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian së bashku me vendet e tjera kontribuese, me themelimin e DHSK-së dhe financimin e punës së saj.

Fondi i ri i krijuar për viktimat, me nismën e DHSK-së

90. Sidoqoftë, Trupi Gjykses theksoi se, në qoftë se viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim, kjo e drejtë do të bëhej e pakuptimtë.

91. Për këtë arsye, Trupi Gjykses gjithashtu rekomandoi krijimin e një fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, me nismën e DHSK-së,

në rast se Kosova nuk i përmbush detyrimet që ka ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtim.

92. Fondi duhet të mbështetet financiarisht para së gjithash nga Kosova, si dhe nga shtete dhe donatorë të tjerë që dëshirojnë t'u ofrojnë mbështetje viktimave.

93. Për arsyet e dhëna në përmbledhjen më lart, Trupi Gjykses:

- a) **LËSHON** Urdhër për Zhdëmtim kundër z. Mustafa;
- b) **KONSTATON** se viktimat V08, 09, V10, V05, V06, V12, V11 dhe V13 provuan, në bazë të standardit të vërtetimit të tërësisë së gjasave, se janë viktimat të krimeve për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor;
- c) **VENDOS** t'u akordojë dëmshpërblim viktimave të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta;
- d) **AKORDON** zhdëmtim individual, në formë të kompensimit;
- e) **CAKTON** si shumë të zhdëmtimit për të cilin z. Mustafa është përgjegjës, 207.000 euro (dyqind e shtatë mijë euro);
- f) **URDHËRON** z. Mustafa t'u paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:

- 30.000 euro viktimës V08;
- 80.000 euro viktimës V09;
- 60.000 euro viktimës V10;
- nga 10.000 euro viktimave V05, V06 dhe V12;
- 5.000 euro viktimës V11; dhe
- 2.000 euro viktimës V13;

Kjo duhet të bëhet brenda afatit që do të përcaktohet nga autoriteti gjyqësor përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim

- g) **KONSTATON** se zotit Mustafa i mungojnë pjesërisht mjetet financiare për zbatimin e këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- h) **LËSHON** “Vendim për Urdhërimin e Dorëzimit të Të Dhënave dhe Dokumenteve me Qëllim Zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim” dhe urdhra të tjerë në lidhje me të, bashkëlidhur këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- i) **URDHËRON** Administratoren të marrë masat e nevojshme për vënien në jetë të këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- j) **FTON** Kryetaren e DHSK-së të caktojë autoritetin gjyqësor i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- k) **FTON** Kosovën të krijojë një mekanizëm të ri zhdëmtimi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së.
- l) **URDHËRON** Administratoren t’ia përcjellë këtë Urdhër për Zhdëmtim, në versionin e redaktuar publik të tij, Qeverisë së Kosovës; dhe
- m) **REKOMANDON** krijimin e një fondi, me nismën e DHSK-së, për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e DHSK-së, në rast se Kosova nuk i përmbush detyrimet e saj ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme, përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtim.

Këtu përfundon përmbledhja e Urdhrit për Zhdëmtim.

Seanca mbyllet.